



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR PËR SHOQËRINË CIVILE

Nr. 6 Prot.

Tiranë, më 23.9.2019

PROCESVERBAL

**Takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të
Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile**

Më datë 23 shtator 2019, ora 11:10, pranë ambjenteve të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) u zhvillua një takim pune me anëtarë të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC).

Në takim marrin pjesë:

Anëtarë të shoqërisë civile të KKSHC-së:

1. Z. Blendi Dibra – *Zv/Kryetar i KKShC-së*
2. Znj. Iris Luarasi
3. Znj. Arta Dyrmishi
4. Z. Vladimir Thanó
5. Z. Ali Coka
6. Znj. Fabjola Laço – Egro
7. Z. Indrit Seferi
8. Znj. Atrida Ferketi
9. Z. Shpëtim Myrto

Përfaqësues nga AMShC:

1. Znj. Paula Bero
2. Z. Andi Luga

Ky takim pune drejtohet nga Blendi Dibra, i cili në fjalën e hapjes falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen dhe vijoi me rendin e ditës:

- Prezantimi i katër anëtarëve të rinj të zgjedhur;
- Monitorimi i zbatimit të “Udhërrëfyesit për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019–2023” të rishikuar të miratuar;
- Diskutim mbi organizimin e Konferencës së Parë Kombëtare të Shoqërisë Civile, ku të ballafaqohen përfaqësues të shoqërisë civile me përfaqësues të Qeverisë dhe komunitetit të donatorëve në lidhje me sfidat e këtij sektori;

- Diskutim mbi agjendën dhe organizimin e mbledhjes së Këshillit si dhe propozimi i caktimit të një date.

Më tej, z. Dibra i dha fjalën anëtarëve të rinj të zgjedhur për të bërë një prezantim të eksperiencës dhe veprimtarisë së tyre në funksion të shoqërisë civile.

Fillimisht fjalën e mori z. Shpëtim Myrto, i cili përfaqëson “*Shoqatën e Përdorimit të Pyjeve dhe Kullotave Komunare ‘DROJA-1’, fshatrat Brret, Picrrage, Gjyraj-Krujë*” dhe është anëtar i zgjedhur për fushën e veprimit B. “*Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor*”.

Më pas vijuan me prezantimin edhe tre anëtarët e tjerë të zgjedhur për fushën e veprimit C. “*Përmirësimi i mirëqenies, shërbimeve sociale, mbrojtjes së shëndetit si dhe cilësisë së jetës*”, përkatësisht: znj. Atrida FERKETI përfaqësuese e “*Gruaja në Integrim (GI)*”; z. Indrit SEFERI përfaqësues i *Shoqatës “MAYA” (Shoqata Rinore Mjekësore Shqiptare)* dhe z. Fabiola LAÇO – EGRO përfaqësuese e *Qendrës për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”*.

Një prezantim të shkurtër mbi veprimtarinë e tyre në shoqërinë civile dhe në KKShC bënë edhe anëtarët e pranishëm.

Z. Coka shprehet se pas punës së tij falas gjatë këtyre dy viteve për fushën e veprimit B. “*Zhvillimi ekonomik-territorialo-mjedisor*” ndjehet i zhgënjyer lidhur me gjobat dhe detyrimet e taksave, pasi nuk ka marrë asnjë projekt të financuar nga taksapaguesit shqiptarë. Gjithashtu ai paraqet edhe një kërkesë dhe shprehet: “*Si delegat i ftuar në Kongresin Botëror të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural i kërkova mbështetje Sekretarit të Përgjithshëm, AMShC-së, KKShC-së dhe nuk na dhanë mbështetje të përfaqësohemi që në fund të fundit është e rrallë. Të lëmë gjurmë me projektet. Problemet me gjobat dhe detyrimet e taksave të diskutohen në Konferencën Kombëtare të Shoqërisë Civile për mbështetje reale. Përfaqësimi ynë në Këshill është në nivel Zëvendësministri, i cili paguhet me pagë shumë të lartë, ndërsa ne punojmë në mënyrë vullnetare.*”.

Më tej, në fjalën e tij z. Dibra shprehet se problemet e ngritura nga z. Coka janë të parashtruara në Udhërrëfyesin e Rishikuar dhe janë diskutuar shpesh gjatë mbledhjeve të anëtarëve të KKShC-së.

Nga ana juridike, ai i sugjeroi anëtarëve të rinj të zgjedhur: “*Të keni parasysh se KKShC është organ i krijuar sipas Ligjit, ku përcaktohet se Këshilli është organ këshillimor pranë Kryeministrisë. Pra dërgojmë këshillimet tona, të diskutuara më parë me organizatat e shoqërisë civile në vend; pastaj marrja parasysh ose jo e tyre nuk duhet të shoqërohet me protesta, ankesa apo deklarata. Faktikisht është Kryetari që mbledh Këshillin dhe e përfaqëson dhe për mendimin tim, Zëvendëskryetari ka një pozicion shumë honorifik, që nuk i kanë lënë ndonjë hapësirë shumë të madhe.*”

Z. Dibra shton, se vërtetë në Ligj thuhet se nuk ka shpërblim, por gjatë gjithë kësaj kohe nuk është gjetur një mënyrë për të hequr shpenzimet e rrugës. Ai vlerësoi se gjatë kohës kur u zhvilluan konsultimet me shoqërinë civile mbi rishikimin e Udhërrëfyesit, ku kishim edhe asistencë të BE-së, të cilët edhe mund të kenë ndihmuar me fonde për realizimin e takimeve, por në një kuptim organet e Qeverisjes e kanë neglizhuar këtë problem. Ai shprehet: “Ne e kemi bërë përcjelljen e këshillimeve drejt strukturave qeverisëse, por nuk duhet të pengohemi për të zhvilluar takimet me bazën / shoqërinë civile. Pasi Këshilli përbëhet nga 27 anëtarë dhe në bazë të Ligjit mbledhja thirret nga Kryetari dhe mbledhjet mbahen në Kryeministri. Ligji na detyron të mblidhemi tre herë në vit. Vitin e kaluar janë realizuar dy mbledhje, ndërsa këtë vit asnjë. Por Kryetari i Këshillit mund të mobilizojë grupet e punës.”.

Në vijim, z. Dibra shprehet: “Pjesa pozitive është miratimi i Udhërrëfyesit të Rishikuar, shumë nga shqetësimet për paraqiti Aliu janë të përfshira në Udhërrëfyes dhe mbetet angazhim i qeverisjes për zbatimin e tij. Janë përfshirë: decentralizimi dhe regjistrimi i OShC-ve, heqja e një personi të detyrueshëm pranë organeve tatimore në rastet kur nuk ke projekt në zbatim etj., në total 159 masa dhe me afate të përcaktuara, ku në disa përfshihet edhe KKShC-ja, por mbetet sfida e Këshillit monitorimi i zbatimit të tij.”.

Z. Dibra, i drejtohet të pranishmëve duke iu referuar pikave të rendit të ditës të këtij takimi dhe shprehet se duhet caktuar një datë për mbajtjen e mbledhjes zyrtare të Këshillit si dhe një agjendë për t’ju propozuar Kryetares së KKShC-së. Ndërsa lidhur me Konferencën Kombëtare edhe për shkak të vizibilitetit, ai ka biseduar me përfaqësues të Partners Albania dhe Drejtorin Ekzekutiv të AMShC-së për të patur edhe prezencën e Kryeministrit.

Më pas fjalën e mori z. Seferi, i cili u shpreh se nga Udhërrëfyesi i Rishikuar ka nxjerrë disa pika për diskutim:

- Meqënëse pjesëmarrja e anëtarëve të shoqërisë civile në KKShC është pa pagesë, të ketë një stimul simbolik financiar, akses logjistik mbi konsulencat që këta anëtarë ofrojnë

Z. Thanó i përgjigjet: “Nuk duhet të shtrohet problemi tek aspekti financiar. Mendoj se duke qenë se do të organizojmë Konferencën Kombëtare, është mirë që të mblidhen disa ekspertë më të mirë që t’i kërkojnë Financës së AMShC-së, sepse ka një fond për mbështetjen e KKShC-së, të ngrejnë një ekip ekspertize dhe të konstatojnë se gjatë këtyre viteve e deri tani ky ishte vizioni dhe mundësia e këtyre anëtarëve. Unë drejtoj pyetjen, a duhet ngritur në Konferencën Kombëtare çështja e riorganizimit të aspektit legjislativ të punës së KKShC-së, se deri tani ose puna jonë ka qenë e cënuar ose nuk kemi vizion për të dërguar pranë Qeverisë ekspertizën, këshillimet tona me disa indikatorë. Mendoj se mund të koordinohemi me Partners Albania dhe organizata të shoqërisë civile për të parë detyrat e Udhërrëfyesit.”

Më pas fjalën e mori znj. Luarasi, e cila edhe shprehet: “Më duket qasje e gabuar diskutimi financiar, megjithëse pajtohem me faktin se anëtarë të cilët vijnë në

takime nga jashtë rrethit të Tiranës nuk duhet t'i paguajnë individualisht konstatet e transportit etj., por duhet të gjendet një mënyrë për t'u financuar. Po flasim në një kontekst, ku Këshilli pothuajse është anonim, nuk është përfaqësuesi i zërit të vërtetë të shoqërisë civile dhe kështu u jap të drejtë atyre që thonë se shoqëria civile është krijuar vetëm për të mbledhur fonde nga donatorë. Mendoj se Konferenca mund të jetë vendi më i mirë edhe për të treguar problemet që ka sektori, por nga ana tjetër nëse ka një gjë që shkon mirë relativisht në këtë vend është shoqëria civile. Politika ka 30 vjet që shkon nga një dështim në tjetrin, por nuk mund ta bëjmë pjesë të shoqërisë civile këtë dështim. Të takohemi shumë shpejt për të përgatitur një Draft-Agjendë të atyre shqetësimeve që duam të ngremë dhe për të kërkuar bashkëpunimin me kushte me Qeverinë, sepse nuk mund të funksionojë këtu siç ka funksionuar deri tani. Roli ynë duhet të jetë edhe *watchdog* i Qeverisë.”

Në vijim, fjalën e mori z. Thanó, i cili në mbështetje të fjalës së znj. Luarasi, tha: “Ne duhet të jemi një mekanizëm orientues, *psh. një spot publicitar, jeni organizatë e shoqërisë civile, si mund t'i drejtoheni Këshillit dhe Këshilli ta çojë më lart?* Pra të vendosim disa hapa se si një grup njerëzish, një grup anëtarësh të shoqërisë civile apo organizatash mund t'i drejtohen Këshillit dhe Këshilli brenda një kuadri 6-mujor jep një përgjigje.”

- Shtimi i frekuencës të takimeve me anëtarët; të ketë një takim çdo muaj deri në muajin Mars.

Lidhur me këtë pikë, z. Thanó shprehet se përveç takimeve të anëtarëve mund të zhvillohen edhe takimet e grupeve të punës sipas tre fushave përkatëse. Edhe kjo duhet të shtrohet në Konferencë.

Ndërsa znj. Luarasi u shpreh se mendon se më e rëndësishme se shtimi i takimeve është arritja e rezultateve pas takimeve të realizuara.

Pas këtyre diskutimeve, z. Dibra pyeti të pranishmit për caktimin e një date të përshtatshme për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit. Të pranishmit ranë dakord të propozojnë datat: 11, 14, 15 tetor 2019.

Më pas, anëtarët e pranishëm propozuan që Draft – Agjenda e Mbledhjes së Këshillit të përmbajë:

1. Organizimi i Konferencës Kombëtare
2. Agjenda e Konferencës Kombëtare
3. Qëllimi i Konferencës
4. Diskutimi i buxhetit
5. Mënyra e orientimit të organizatave në KKShC
6. Rishikimi i Ligjit për KKShC-në

7. Ecuria e KKShC-së
8. Arritjet, sfidat dhe roli i shoqërisë civile
9. Etj.

Lidhur me organizimin e Konferencës, anëtarët e pranishëm u shprehën se ky event do të ketë asistencë teknike dhe mbështetje financiare nga AMShC dhe Partners Albania si dhe sugjeruan që të realizohet edhe mbledhja e informacioneve e kërkesave të organizatave të shoqërisë civile:

- Informimi dhe interaktivitet me OShC-të të zhvillohen nëpërmjet faqes web dhe rrjete sociale të AMShC/KKShC;
- Komunikimet e-mail të personalizuara me organizatat *think tank* dhe që kanë patur rol në draftimin e Udhërrëfyesit

Z. Thanë sugjeroi që pas disa ditësh të mblidhet një grup ku të diskutohen disa çështje dhe t'i drejtohen Kryetares së Këshillit dhe t'i thuhet se nga Konferenca parashikohet të dalin këto rezultate.

Z. Dibra e deklaroi takimin të mbyllur në orën 12:10.

Mbajti procesverbalin

Paula Bero